VENDIM
Nr. 15, datë 28.4.2017

PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME TEPELENË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të lgjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjellës Kanalizime Tepelenë me:
Drejtues Ligjor Arben Kacorri
Drejtues Teknik Amarildo Tola
2. Operatori Sh.a Ujësjellës Kanalizime Tepelenë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:
Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura;
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është:
Bashkia Tepelenë
Bashkia Memaliaj
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

KRYETARI

Ndriçim Shani